



WORLD BANK GROUP

Finance, Competitiveness & Innovation

Financial Sector Advisory Center (FinSAC)



PËRMBLEDHJE

Konferenca Rajonale me temë "Planifikimi i rimëkëmbjes dhe ndërhyrjes së jashtëzakonshme"



PËRMBLEDHJE

Konferenca Rajonale me temë "Planifikimi i rimëkëmbjes dhe ndërhyrjes së jashtëzakonshme"

Qendra FinSAC e Bankës Botërore, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, organizuan Konferencën Rajonale për planifikimin e rimëkëmbjes dhe ndërhyrjes së jashtëzakonshme në banka, më 15 nëntor 2018 në Tiranë. Në këtë konferencë morën pjesë rreth 50 përfaqësues të nivelit të lartë dhe ekspertë nga autoritete mbikëqyrëse dhe të ndërhyrjes së jashtëzakonshme nga vende të Bashkimit Evropian, vende kliente të FinSAC, si dhe përfaqësues të bankave tregtare në Shqipëri. Folësit në konferencë ishin përfaqësues nga Banka e Shqipërisë, Bordi i Përbashkët i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme (SRB), Banka Qendrore Evropiane, Banka Kombëtare e Kroacisë, Banka Kombëtare e Republikës Çeke, dhe Banka e Italisë. Zhvillimet e deritanishme të rimëkëmbjes dhe ndërhyrjes së jashtëzakonshme në Bashkimin Evropian dhe sfidat për zbatimin e tyre në rajonin tonë ishin në fokus të kësaj konference rajonale. Vendet pjesëmarrëse në konference kishin përfunduar së fundmi ose janë në proces të përafritit të kuadrit të tyre me standardet e BE-së që kanë të bëjnë me bankat që përballen me një krizë apo me një situatë të pashmangshme paafësie paguese. Konferenca ofroi një platformë ku autoritet rajonale mund të shkëmbejnë përvojat e tyre, të vlerësonin arritjet e deritanishme dhe të përgatiteshin për sfidat kyçe të mëtejshme, duke rritur funksionimin e kuadrit të ri me qëllimin që bankat të rimëkëmben pa krijuar destabilizim financiar apo më të gjerë ekonomik.

Shënim:

Kjo përmbledhje u përgatit nga Pamela Lintner (Specialiste e lartë e FinSAC) dhe Lira Qefalia (këshilltare pranë FinSAC) bazuar në prezantimet e folësve gjatë konferencës. Gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë dokument janë tërësisht ato të autorëve dhe nuk përfaqësojnë pikëpamjet e drejtpërdrejta të prezantuesve dhe të institucioneve të tyre përkatëse. Ndonëse është bërë çdo përpjekje për të siguruar se ky informacion është i saktë, autorët shkarkojnë veten nga përgjegjësia apo detyrimi ndaj çdo pale për humbje, dëmtim ose shkelje të krijuar nga gabime apo harresa, qoftë kur këto gabime apo harresa vijnë nga neglizhenca, aksidentalisht apo për shkaqe të tjera.

Punimet e Konferencës u hapën nga **Zëvendësguvernatorja e Dytë e Bankës së Shqipërisë, zj. Natasha Ahmetaj**. (fjala e publikuar në faqen e BIS: <https://www.bis.org/review/r181122c.htm>) Zj. Ahmetaj vuri në dukje se Modeli i integritit global është modeli ekonomik që ka ndjekur edhe shumica e vendeve në tranzicion, përfshirë Shqipërinë. Sipas këtij orientimi, tregu bankar shqiptar ka dëshmuar vullnet dhe objektiva të qarta për një harmonizim sa më të shpejtë me standardet ndërkombëtare dhe, në veçanti, me kuadrin ligjor të Bashkimit Evropian. Megjithatë, në historinë e sektorit bankar shqiptar fatmirësisht nuk kemi pasur raste të falimentimit të bankave, ne e identifikojmë të njëjtat mangësi në legjislacionin tonë bankar, sikurse edhe ekonomitë e tjera evropiane. Duke ndërtuar skenarë hipotetikë për përballimin e një ekspozimi potencial të ekonomisë shqiptare ndaj krizës së borxhit sovran grek, u evidentua se Banka e Shqipërisë - si autoriteti mbikëqyrës për sektorin bankar - nuk i kishte të gjitha instrumentet e duhura ligjore për administrimin e situatave të paafësisë paguese në bankat me rëndësi sistemike. Zj. Ahmetaj theksoi se, kjo nevojë për një kuadër të ri ligjor trajtohet si në aspektin kombëtar edhe atë ndërkufitar në Direktivën Evropiane për Rimëkëmbjen dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Banka (BRRD) si dhe në rregulloret përkatëse mikro dhe



makroprudenciale. Për këtë arsye, gjatë vitit 2015, me mbështetjen e projektit FinSAC të Bankës Botërore, Banka e Shqipërisë filloi punën e vështirë, por të domosdoshme, për harmonizimin e Direktivës, në një ligj të ri shqiptar. Ligji “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë” hyri në fuqi në korrik 2017. Zj. Ahmetaj shtoi se, pas zbatimit me sukses të disa hapave, si vlerësimi i planeve të rimëkëmbjes, miratimi i akteve kryesorë nënligjore, dhe zhvillimi i proceseve të brendshme dhe ndërinstitucionale, mbeten ende të pranishme disa sfida në lidhje me funksionimin e kuadrit të ri për ndërhyrjen e jashtëzakonshme për autoritetet në Shqipëri, në vendet e rajonit dhe më gjerë ato evropiane. Si rrjedhim, kjo konferencë ishte një mundësi për të shkëmbyer përvoja dhe për të vlerësuar arritjet e deritanishme. Në përfundim, zj. Ahmetaj u shpreh e bindur se punimet e kësaj konference, ndër të tjera, do të mundësojnë ndërtimin urave të reja me qëllim bashkërendimin e përpjekjeve për një sistem të qëndrueshëm financiar brenda dhe jashtë kufijve gjeografikë.



Zj. Manjola Dyrmishi nga Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë ofroi një përmbledhje të historisë së prezantimit të planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në Shqipëri, duke u përqendruar në përmirësimet, dobësitë, rastet përjashtimore si dhe objektivat për të ardhmen, porë nga këndvështrimi i mbikëqyrjes.

Planet e rimëkëmbjes filluan të dorëzohen vetëm për bankat me rëndësi sistematike në Shqipëri (7 nga 16 banka) në periudhën 2012-2013, mbështetur në udhëzimet dhe rekomandimet e Bordit të Stabilitetit Financiar (FSB). Pas komunikimit të vazhdueshëm për krijimin e kërkesave formale, në vitin 2014, Banka e Shqipërisë zhvilloi udhëzime detyruese, duke u kërkuar bankave të miratonin planet e rimëkëmbjes dhe t'i dorëzonin ato gjatë vitit 2015. Cilësia dhe konsistenca e tyre ndryshonte shumë nga njëra bankë te tjetra; ndërkohë që bankat me kapital të huaj u mbështetën më së shumti të ndihma dhe ekspertiza e bankave mëmë, bankat vendase shfrytëzuan ekspertizën e huaj.




Në kuadër të zhvillimeve të reja ndërkombëtare dhe harmonizimit të parashikuar me Direktivën për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme dhe Rimëkëmbjen në Banka¹, Banka e Shqipërisë udhëzoi bankat tregtare të merrnin parasysh kërkesat dhe udhëzimet e tjera shtesë të parashikuara nga BRRD/Autoriteti Bankar Evropian (EBA) si dhe nga FSB-ja. Pas hyrjes në fuqi të ligjit për ndërhyrjen e jashtëzakonshme dhe rimëkëmbjen, Banka e Shqipërisë miratoi rregulloren për planifikimin e rimëkëmbjes, në qershor 2017. Ky akt i ri nënligjor, në përputhje me standardet teknike të EBA-s, përmban formularët standardë raportues dhe kërkon dorëzimin e planeve të hartuar sipas proceseve të vlerësimit të brendshëm për mjaftueshmërinë e kapitalit (ICAAP) të BE-së, me qëllim vlerësimin dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së treguesve cilësorë dhe sasiorë të rimëkëmbjes, ndikimin e veprimeve të propozuara të rimëkëmbjes në kapitalin e bankave, likuiditetin, levën financiare, dhe në tregues të tjerë financiarë, si edhe tërësinë e skenarëve të stresit financiar të përdorur në plane. Në mars 2018, bankat me rëndësi sistematike dërguan planet vjetore të rimëkëmbjes në përputhje me rregulloren e re në fuqi "Udhëzime për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme dhe Planet e Rimëkëmbjes" të miratuar nga Banka e Shqipërisë. Gjatë gjithë kësaj periudhe, ka pasur një dialog të efektshëm dhe të vazhdueshëm me bankat.

Nga 13 banka që dërguan planet e rimëkëmbjes, 6 banka i hartuan këto plane për herë të parë, 7 banka dërguan plane të plota të rimëkëmbjes, dhe 6 të tjera dërguan plane të thjeshtëzuara të rimëkëmbjes. Nga vlerësimi i tyre, u arrit në përfundimin se, në përgjithësi, bankat kanë ndjekur strukturën e rekomanduar nga rregullorja; skenarët dhe masat e treguara në plan jepen të detajuara; dhe treguesit e paralajmërimit të hershëm ishin në përputhje me rezultatet e ICAAP. Për më tepër, bankat që kishin kaluar situata stresi gjatë viteve të fundit, i përfshinë ato në skenarët me masat përkatëse sipas skenarëve, planet e komunikimit u përmirësuan, dhe u ofrua një paraqitje më e mirë e detyrave të caktuara njësisë të ndryshme dhe një integrim më i mirë me të gjithë kuadrin për administrimin dhe monitorimin e rrezikut.

Megjithatë, ka vend për përmirësim dhe disa aspekteve të planeve të rimëkëmbjes duhet të vazhdohet t'u kushtohet vëmendje. Lidhur me këtë, Banka e Shqipërisë ve në dukje paqartësinë e vazhdueshme në lidhje me autoritetin që do të duhet të aktivizojë, zbatojë dhe çaktivizojë planin e rimëkëmbjes, duke iu referuar Këshillit Drejtues apo Këshillit Mbikëqyrës; ALCO²; Ekipi për Administrimin e Krizave apo Drejtuesit Ekzekutivë. Në një konstatim lidhur me këtë, megjithëse skenarët ishin të detajuar, më shumë se sa një skenar i kombinuar i ngjarjeve sistematike skenari i kombinuar duket të jetë një agregim mekanik i ngjarjeve idiosinkratike. Në këtë drejtim, bankat mund të parashikojnë në mënyrë jo reale një rritje të të ardhurave neto në situatë stresi apo të marrin parasysh mundësi të njëjta sipas të gjithë skenarëve. Për më shumë, nuk kishte asnjë vlerësim të efekteve anësore të opsioneve, d.m.th shitje e kredive me probleme pa marrë parasysh rritjen e kredisë me probleme, rritje e normave të interesit gjatë krizave reputacionale, transferim i likuiditetit midis monedhave pa marrë parasysh rrezikun e kursit të këmbimit, dhe kursimet nga ulja e përfitimeve për punonjësit pa marrë parasysh efekte mbi reputacionin dhe motivimin. Gjithashtu, supozimet për rritjen e kapitalit, si në terma të kohës dhe të shumave, duket mjaft optimist në pjesën më të madhe të rasteve. Duhet vënë në dukje se, disa opsione të marra parasysh nuk janë testuar asnjëherë nga bankat. Në të njëjtën mënyrë, nevojitet një përqasje e fortë për treguesit: nivelet e caktuara në disa raste janë më të ulëta se sa kufijtë minimalë rregullatorë, ka intervale të ngushta midis paralajmërimit të hershëm dhe niveleve fillestare, si dhe nuk janë marrë parasysh disa tregues ose këta janë kombinuar në një të vetëm. Për sa i përket identifikimit të linjave të veprimtarisë dhe funksioneve kritike, disa banka me rëndësi sistematike supozojnë se ato nuk ofrojnë ndonjë funksion kritik dhe mund të ofrojnë më shumë detaje për linjat e veprimtarisë së tyre.

¹ BRRD: Directive 2014/59/EU of the European Parliament and of the Council, 15 May 2014.

² ALCO – Asset-Liability Committee.



Ndërsa synon forcimin e dialogut efektiv dhe të vazhdueshëm me bankat, Banka e Shqipërisë ka për qëllim të sigurojë përputhshmëri më të lartë me kuadrin e brendshëm të ICAAP, të forcojë rishikimin e treguesve dhe kërkesave bazuar në mësimet e nxjerra, të inkurajojë vazhdimisht bankat të marrin parasysh më shumë skenarë, më shumë opsione të rimëkëmbjes dhe të testojnë në mënyrë të përshtatshme shkallën e realizimit të këtyre të fundit.

Prezantimi nga z. Eduardo Ávila Zaragoza dhe zj. Elsa Martinez nga **Banco Bilbao Vizcaya Argentaria (BBVA)** ofroi një pasqyrë të qasjes së BBVA-së ndaj planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe rimëkëmbjes, si institucion bankar global bazuar në pika të shumfishta të zbatimit të ndërhyrjes (MPE). Të jesh një bankë sipas MPE³-së do të thotë se, nëse ndonjë nga degët e grupit ka probleme të aftësisë paguese, likuiditeti ose operacionale, Autoritetit i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund të likuidojë atë degë pa ndikuar pjesën tjetër të grupit. BBVA-ja këshilloi se një grup i MPE-së duhet të bazohet në një model biznesi të decentralizuar ku degët janë thellësisht të vetë-mjaftueshme lidhur me: financimin dhe kapitalin, strukturën ligjore, drejtimin dhe operacionet. Në përcaktimin e grupit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, BBVA-ja ndjek kriteret paraprake, sipas të cilave: i) grupet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme veprojnë në përputhje me parimin e vet-mjaftueshmërisë dhe të veçueshmërisë; ii) grupet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme harmonizohen me perimetrin prudencial dhe me regjimin e juridiksionin për ndërhyrjen e jashtëzakonshme; iii) çdo subjekt i përket një grupi të ndërhyrjes së jashtëzakonshme; iv) përgjegjësia për të përcaktuar perimetrin e fundit të grupit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme bie mbi kolegjin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe ekipit të brendshëm të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Vlerësimi MPE i BBVA-së vë në dukje se çdo degë e BBVA-së/grup i ndërhyrjes së jashtëzakonshme ka kapitalin e vet rregullator dhe instrumentet e financimit dhe se BBVA-ja ka një numër të kufizuar ndërlidhesh financiare. Gjithashtu, lidhur me likuiditetin, degët janë të vetë-mjaftueshme dhe përgjegjëse për administrimin e likuiditetit të tyre pa transferime të fondeve brenda grupit (marrja e depozitave ose të futen në treg në bazë të vlerësimit rating të tyre) dhe ku kompania mëmë përcakton politika për likuiditetin dhe rrezikun. Çdo pikë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme ka aktet e veta nënligjore të shoqërisë dhe këshilla të veçantë dhe të pavarur të korporatës. Degët operacionale të BBVA-së kanë nënshkruar **marrëveshjet në nivel shërbimi (SLA) për të ofruar shërbime deri në 24 muaj**, nëse ata largohen nga grupi për shkak të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të BBVA-së. Lidhur me kanalet e tjerë që ndikojnë në realizueshmërinë, pjesa më e madhe e njësisë të BBVA-së, kanë një Nivel vlerësimi pikësor nga klientët (Net Promoter Score) mbi palët e tyre, i cili mund të minimizojë ndikimin e ndarjes nga Grupi, si dhe vlerësim afatgjatë BBB+ sipas Standard and Poor's, e cila i mundëson të hyjë në treg individualisht. Duke supozuar se strategjia afatgjatë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme e BBVA-së është MPE, ekipi i saj i brendshëm i ndërhyrjes së jashtëzakonshme (IRT) ka identifikuar 11 pika të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Në varësi të kuadrit rregullator, përgjegjësia hartuese për ndërhyrjen e jashtëzakonshme dhe rimëkëmbjen është ose e njësisë ose e autoritetit. Duke pasur parasysh kuadrin rregullator dhe institucional të BBVA-së, zhvillimi i vazhdueshëm i planit për ndërhyrjen e jashtëzakonshme dhe rimëkëmbjen në grupin e BBVA-së ka strukturën e mëposhtme:




³ MPE – (ang.): Multiple Points of Entry.



Marrëdhëniet me autoritete mbahen nëpërmjet bisedave dhe seminareve të përditshme (seminare me IRT: 2-3 herë për cikël të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe seminare me JST: një herë në vit). Zhvillohen edhe takime vjetore më formale të kolegjeve për ndërhyrjen e jashtëzakonshme dhe të kolegjeve mbikëqyrëse.

Tërësia e instrumenteve të mëposhtëm tregon se si BBVA-ja integron planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme si pjesë e procesit të administrimit të rrezikut të bankës.


Recovery plans as part of a management toolkit




Consistency among capital and liquidity plans is safeguarded in terms of governance, indicators, scenarios, measures, etc.

BBVA-ja mbështet fuqimisht zhvillimin e kulturës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe të rimëkëmbjes; si dhe drejtimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Ajo thekson nevojën për të kuptuar kërkesat rregullatorë, zgjedhjen mes Kërkesës minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar (MREL⁴) ose zbatueshmërisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme, integrimin e planifikimit të rimëkëmbjes dhe ndërhyrjes së jashtëzakonshme në veprimtarinë e zakonshme dhe forcimin e funksionimit të BAU duke punuar për zbatueshmërinë e NJZ, si elementin përbërës kryesor në këtë integrim. BBVA-ja vë në dukje nevojën e përfshirjes së nivelit të lartë të drejtimit në zhvillimin e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Qeverisja e saj për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme kryhet nga caktimi i një anëtarit nga drejtuesit e lartë përgjegjës për të rritur nivelin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, si dhe nga një person për të trajtuar programin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme çdo ditë, dhe që shërben si pikë kryesore kontakti. Për më shumë, BBVA-ja ka krijuar një ekip të brendshëm shumë disiplinor të koordinuar nga Zyra e Brendshme e Planifikimit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për të trajtuar çështjet e përditshme të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe si pikë kontakti me autoritetet për ndërhyrjen e jashtëzakonshme. Grupi i punës për rimëkëmbjen gjithashtu koordinohet ngushtësisht me grupin e punës për ndërhyrjen e jashtëzakonshme. Puna për planifikimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe rimëkëmbjen përfshin edhe informacion nga autoritetet dhe zhvillime rregullatorë si dhe zhvillimin e një vizioni të brendshëm për ndërhyrjen e jashtëzakonshme.

⁴ MREL – (ang.): Minimum requirement for own funds and eligible.






Duke njohur rëndësinë e vazhdimësisë së veprimtarisë, BBVA-ja ka zhvilluar një metodologji grupi të gjerë për të garantuar vazhdimësinë operacionale. Kjo nis me identifikimin e shërbimeve të përbashkëta kritike (CSS) dhe shpërndarjen e tyre mes funksioneve kritike dhe linjave kryesore të veprimtarisë. Vazhdon më një klasifikim të ofruesve dhe shpërndarjen e tyre ndaj CSS-ve; zhvillimi i një analizë të vazhdueshmërisë operacionale. Përfundon me ruajtjen (depozitimin) e kontratave dhe karakteristikat kryesore. BBVA-ja ka përfshirë klauzola të provës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme si standard në kontratat si me ofruesit e jashtëm dhe me ata të brendshëm, që ndër të tjera: rregullojnë ndalimin e përfundimit të parakohshëm për shkak të ndërmarrjes së veprimeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme; lejojnë transferueshmërinë e kontratave tek një palë e tretë pa dakordësinë e siguruesit; kërkojnë vazhdimësinë e mundur të ofrimit të shërbimit deri në dy vjet pas transferimit të një veprimtarie ose subjekti, ndërsa thekson se rëndësia e një shërbimi varet nga vlerësimi i autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në pikën e ndërmarrjes së veprimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

BBVA-ja është një grup bankar me shpërndarje globale dhe kuadër të fortë drejtues që i mundësojnë të ruajë strukturë të thjeshtë në çdo vend, me komitete dhe procedura mbikëqyrëse. Si rregull i përgjithshëm ai mban vetëm një lloj subjekti (bankë, etj.) në çdo vend (përveç Spanjës). Në përgjigje të kërkesave rregullatore, ajo e ka zvogëluar numrin e kompanive zotëruese ndërmjetësuese, që nuk financohen me hua dhe kontribuojnë në ristrukturimin e rregullt të grupit. BBVA-ja mund të ofrojë menjëherë strukturën aktuale ligjore të grupit, të listojë degët, pronësinë e saj dhe strukturën drejtuese, si dhe treguesit kryesorë të çdo dege. BBVA-ja administron një plan thjeshtëzimi dhe racionalizimi të strukturës së grupit; ajo nxit një plan të vazhdueshëm racionalizimi për të thjeshtëzuar strukturën e saj, por në ekuilibër të përshtatshëm me nevojat e veprimtarisë. Thjeshtëzimi i strukturës së degëve të grupit për të lehtësuar një ndërhyrje të jashtëzakonshme të rregullt dhe të shpejtë (sipas strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme MPE) është arritur, për shembull, duke minimizuar marrëdhëniet e pronësisë midis subjektit dhe grupeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe përqendrimit, sa më shumë që të jetë e mundur, për pronësinë.

BBVA-ja mban pozicionin e bankës globale mbi të cilën mund të zbatohet ndërhyrja e jashtëzakonshme në nivel global nëpërmjet MPE-së, pasi, megjithëse është një bankë e madhe, ajo ruan një strukturë të thjeshtë dhe grupet e ndryshme të ndërhyrjes së jashtëzakonshme janë të vetë-mjaftueshëm dhe të



ndarë, ndërsa shërbimet operacionale dhe sistemet e informacionit janë të përgatitur për ndërhyrje të jashtëzakonshme. BBVA-ja ka zhvilluar një kulturë të ndërhyrjes së jashtëzakonshme duke përfshirë komponentë të ndryshëm: (i) zbatueshmëria e ndërhyrjes së jashtëzakonshme është sot një drejtues i planifikimit strategjik; (ii) bordi dhe menaxhimi i nivelit të lartë kanë përvetësuar nevojën për të zbatuar ndërhyrjen e jashtëzakonshme; (iii) një zyrë e brendshme për planifikimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme është e angazhuar me të gjithë departamentet dhe juridiksionet. Në përfundim, BBVA-ja thekson rëndësinë e të punuarit ngushtë me autoritetet për të kuptuar përjasjen dhe shqetësimet e tyre, për të shpjeguar modelin dhe strukturën e veprimtarisë dhe për të përmbushur pritshmëritë se banka po bën përpjekje për të rritur shkallën e zbatueshmërisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme e cila duhet të pasqyrohet në kalibrimin e MREL-së.

Prezantimi për “Zhvillimet kryesore në planifikimin e rimëkëmbjes në BE” nga Kathrin M. Zander, Mbikëqyrëse, DGMS1 – Mbikëqyrja Mikroprudenciale, ofroi një përmbledhje të vlerësimit të planifikimit të rimëkëmbjes në BE/Banka Qendrore Evropiane (BQE), duke trajtuar mënyrën se si planifikimi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme ndikon planifikimin e rimëkëmbjes. Vlerësime të planit të rimëkëmbjes janë bërë pjesë e programit vjetor të inspektimit mbikëqyrës të Mekanizimit të Vetëm Mbikëqyrës (SSM⁵). Në mënyrë më specifike, plani i rimëkëmbjes përmban informacionin e mëposhtëm:



Planet e rimëkëmbjes vlerësohen nga mbikëqyrësi për plotësinë, cilësinë, dobishmërinë dhe, mbi të gjitha, besueshmërinë tyre. Për më shumë, dobishmëria e planit të rimëkëmbjes është thelbësore për të siguruar që veprimet të ndërmerren në kohë. Së fundmi, BQE-ja ka publikuar një raport bazuar në vlerësimet e planit të rimëkëmbjes, i cili vë në dukje gjetjet kryesore.⁶ Raporti ofron një panoramë të gjerë të sistemit, duke pasur për qëllim të ndihmojë bankat në eurozonë të përmirësojnë planet e tyre të rimëkëmbjes, në lidhje me mundësitë e rimëkëmbjes, kapacitetin dhe treguesit e përgjithshëm të rimëkëmbjes, si dhe zhvillimin e udhëzuesve me sugjerime e rregulla si dhe të praktikave me ushtrime.

Përzgjedhja e tërësisë së duhur të treguesve (pragjeve) është thelbësore për një rimëkëmbje efektive. Si praktikë standarde, treguesit duhet të kenë për qëllim: i) të tregojnë faktorët kryesorë të veprimtarisë dhe rreziqeve të bankës dhe të analizojnë aspektet me këndvështrim nga e ardhmja (për shembull treguesit e kolateralizimit të aktiveve); ii) të përfshijnë kërkesat rregullatore; iii) të përfshijnë treguesit MREL më të fundit, kur MREL bëhet detyrues dhe i zbatueshëm; iv) të sigurojnë që kufijtë e treguesit janë të kalibruar që të lejojnë kohën e duhur dhe aftësinë për të reaguar (për shembull shtesat për treguesit e likuiditetit); v) të sigurojë se treguesit e rimëkëmbjes janë pjesë dhe në përputhje me kuadrin e administrimit të rrezikut; dhe vi) të sigurojë se drejtuesit/mbikëqyrësit informohen pa vonesë (max.24 orë). Mbulimi i duhur i subjekteve të grupit është bërë një fokus i rëndësishëm me kalimin e kohës, deri në fund të 2017, bankat përpiqeshin me mbulimin e duhur të subjekteve ligjore materiale në një plan rimëkëmbjeje të grupit. EBA u përgjigj duke publikuar një tërësi rekomandimesh, duke ofruar qartësi sipas detajimit që kërkohej.

⁵ SSM – (ang.): Single Supervisory Mechanism

⁶ <https://www.bankingsupervision.europa.eu/press/supervisory-newsletters/html/index.en.html>



Për të kuptuar si planifikimi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme ndikon planifikimin e rimëkëmbjes, së pari duhet të shpjegojmë konceptet e ndryshme të strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme sipas MPE-së, dhe strategjive të zgjidhjes së jashtëzakonshme sipas SPE⁷. Sipas një strategjie të ndërhyrjes së jashtëzakonshme MPE, një bankë duhet të ketë aftësi të mjaftueshme përthithëse të humbjeve në nivele individuale degësh, të bazohet në një model veprimtarie të decentralizuar dhe të degë të mundshme që mund të qëndrojnë vetë, të ketë drejtim korporate individuale të fortë dhe vendimmarrje individuale, si dhe zbatim vendor të politikave. Sipas një strategjie të ndërhyrjes së jashtëzakonshme SPE, aftësia e mjaftueshme e përthithjes së humbjeve nga jashtë ruhet në nivel banke mëmë, banka bazohet në një model veprimtarie të decentralizuar (për shembull banka mëmë ofron kapital dhe financim, ndërlidhje në nivel të lartë) dhe gjithashtu proceset e vendimmarrjes përqendrohen në nivel banke mëmë.

Për më tepër, ndaj organizimit të një banke dhe përcaktimit ligjor, faktorët “zbutës” mund të drejtojnë vendimin e autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme drejt përzgjedhjes së strategjisë së preferuar të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Për shembull, dallimet në regjimet ligjore mund të pengojnë një strategji ndërkufitare SPE; përvojat e mira të mëparshme midis autoriteteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe mbikëqyrës në diskutimin dhe zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme dhe një angazhim të besueshëm bashkëpunimi midis autoriteteve në kohë stresi mund të favorizojnë një SPE. Mos bashkëpunimi i mundshëm i autoriteteve bëhet më i dukshëm për subjekte më të mëdha dhe materiale. Përjasje hibride gjithashtu janë të mundshme (për shembull SPE për degët e BE-së, MPE për degët jashtë BE-së).

Për sa u përket efekteve të mundshme të strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme për mbikëqyrjen gjatë veprimtarisë normale të biznesit, përjasja e preferuar e ndërhyrjes së jashtëzakonshme mund të mos jetë në përputhje me përjasjet aktuale mbikëqyrëse dhe të ketë efekte në planifikimin e rimëkëmbjes së një grupi. Sipas një strategjie MPE të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, pyetja që ngrihet është, nëse subjektet e një grupi duhet të mbikëqyren në mënyrë më të pavarur, dhe anasjelltas, nëse sipas një strategjie SPE mbikëqyrësit e duhet të nxisin integrimin e mëtejshëm të grupit, gjithashtu nga një këndvështrim mbikëqyrës. Lidhur me efektet e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme në planet e rimëkëmbjes në nivel grupi, sipas një përjasjeje SPE, planet e grupit pasqyrojnë modelin e integruar të veprimtarisë dhe lëvizjen e fondeve nëpër grup në një situatë krize. Sipas një strategjie MPE, planet e rimëkëmbjes së një grupi ende vlerësohen të përshtatshme; megjithatë, ato duhet më e pakta të tregojnë më shumë **rimëkëmbjen e pavarur të subjekteve ligjore materiale** që janë pika të hyrjes për ndërhyrjen e jashtëzakonshme. Lidhur me këtë, **opsionet individuale të likuiditetit** janë me rëndësi kyçe dhe ku mundet të jetë e mundshme, burimet e jashtme për financimin e kapitalit duhen hulumtuar por **MPE nuk e ndalon automatikisht qasjen në burimet e grupit në një krizë: subjektet e grupit ende mund të ndihmojnë njëri tjetrin, për aq kohë sa ndihma financiare nuk përhapet në të gjithë grupin. Kështu që, duke marrë parasysh MPE-në në planifikimin e rimëkëmbjes ndikohet rimëkëmbja e bankës së veçuar.** Me qëllim dallimin e një krize që po shfaqet, duhet të vendosen mekanizma monitorimi dhe përshkallëzimi të hartuar në mënyrë të përshtatshme jo vetëm në nivel të konsoliduar por edhe në nivel lokal. Grupet duhet të instalojnë një qark informacioni për të siguruar se problemet nuk trajtohen tërësisht në mënyrë të vetme (në mënyrë individuale). Për më tepër, treguesit e rimëkëmbjes duhet të jenë të zbatueshëm në nivel lokal dhe një numër i mjaftueshëm mundësisht të besueshme duhet të jenë të vlefshme për degët lokale, për shembull, lidhur me aftësinë financiare, burimet njerëzore, dhe aftësinë e sistemit. Testimi i planit të rimëkëmbjes së grupit duhet të përfshijë

⁷ SPE - Single Point of Entry. Ndërhyrja e jashtëzakonshme në grupin bankar duke nisur nga pjesa më e lartë e grupit bankar deri në nivelin më të poshtëm, për të shpëtuar të gjithë grupin.



në mënyrë të përshtatshme degët/pikat përkatëse të hyrjes, jo domosdoshmërisht nëpërmjet hartimit të një plani individual për çdo degë, por duke përfshirë degët në analizë, veçanërisht sipas MPE-së.

Gjatë " Trajtimin të krizës" duhet të adresohet edhe pyetja nëse mundësitë e rimëkëmbjes janë mjaftueshëm të qëndrueshme për të administruar një goditje. Gjithashtu, një trajtim i veçantë e rimëkëmbjes nuk ndalon marrjen e mbështetjes nga subjekte të tjera të grupit për aq kohë sa infektimi nuk përhapet. Janë ngritur pikëpyetje lidhur me atë se çfarë e përcakton një mundësi rimëkëmbjeje të besueshme si në nivel grupi dhe në nivel lokal. Opsionet e rimëkëmbjes që janë analizuar mirë nuk lënë hapësira për paqartësi pasi përmbajnë:


- Informacion thelbësor për drejtimin e bankës për të marrë një vendim të informuar në një situatë stresi.
- Detaje për ndikimin financiar/operacional (aktuale dhe të projektuare) dhe normën e suksesit të mundësive të rimëkëmbjes.
- Informacion për varësinë mes mundësive dhe përjashtimin e njëra-tjetrës .

Ndërhyrja e jashtëzakonshme ndikon shumë përfaqësimin mbikëqyrës. Është e rëndësishme që autoritetet (njësitë) mbikëqyrëse dhe të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bien dakord për një kuadër për shkëmbin informacioni pa kufizuar tepër fushat e shkëmbimit. Shkëmbimi duhet të përfshijë informacione të mbikëqyrjes për dokumentimin e procesit të brendshëm të vlerësimit të mjaftueshmërisë së kapitalit (ICAAP) dhe procesit të brendshëm të vlerësimit të mjaftueshmërisë së likuiditetit (LAAP), vlerësimin e detajuar me shkrim dhe atë pikësor të procesit të rishikimit dhe vlerësimit mbikëqyrës (SREP), të dhëna rregullatore mbikëqyrëse, planet e biznesit dhe përditësimet, si dhe raportet e mbikëqyrjes në vend dhe të ecurisë së rekomandimeve. Në qoftë se kushtet e një banke po përkeqësohen atëherë duhet të shkëmbehet edhe informacioni vijues: dokumentacion i detajuar mbi të cilën është bazuar SREP, planin e bankës për të rivendosur përputhshmërinë me kërkesat mbikëqyrëse, vendimet për ndërhyrjen e hershme, përfshirë vlerësimin e aktiveve dhe pasiveve, si dhe një përditësim për bankën pas zbatimit të masave të ndërhyrjes së hershme. Përveç planit të rimëkëmbjes, BQE këshillon që të mos harrohet se strategjia e preferuar e ndërhyrjes së jashtëzakonshme mund të ndikojë edhe në fushat e mëposhtme,, por jo vetëm: kërkesat dhe vendimet për heqje dorë, modelet e regjistrimit kontabël dhe modelet e brendshme, përfaqësimin mbikëqyrës - për MPE mund të ketë nevojë të sigurohet një aftësi e nëngrupeve/ degëve për t'u vetë-rimëkëmbur dhe vijuar veprimtarinë dhe një aftësi e përthithjes së humbjeve dhe të rikapitalizimit (për shembull nëse MREL mund të jetë më e lartë në total sipas MPE, duke marrë supozimin se tepricat MREL nuk do të zhvendosen midis subjekteve, dhe të jenë më të ulëta në total nën SPE, duke pasur parasysh supozimin të mbështetjes brenda grupit në një krizë), vendimet e drejtimin të bankës, për shembull emetimin e detyrimeve apo drejtimin dhe administrimin e grupit.

Planifikimi i duhur i ndërhyrjes së jashtëzakonshme kërkon vite, jo muaj. Përderisa bankat nuk mund të vlerësohen apo ndryshohen brenda ditës, zhvillimi i planeve të veprimit duhet të jetë i dobishëm. Këto plane duhet të diskutohen dhe të kenë rënë dakord paraprakisht të gjithë palët e përfshira. Planifikimi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme është një çështje delikate - për të shmangur keqinterpretimin është thelbësore të ndërmerren takime të rregullta me kundërpartitë. Shkëmbimi i programeve të punës do të lehtësonte planifikimin e brendshëm të të gjithë palëve të përfshira.




Zj. Denada Prifti nga Bordi i Përbashkët i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme (SRB) prezantoi “Zhvillimet e fundit në planifikimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në BE”. Ajo foli për objektivat dhe detyrat kryesore të ndërhyrjes së jashtëzakonshme; përfaqshjen e planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të SRB-së; dhe zhvillimet e fundit, duke theksuar programin e punës për mundësinë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe përfaqshjen e MREL. Për sa i përket objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme; theksi u vu në sa më poshtë vijon: (i) sigurimi i vazhdimësisë së funksioneve kritike; (ii) ruajtja e stabilitetit financiar në një shtete anëtar ose në nivel më të lartë; (iii) mbrojtja e taksapaguesve nga përdorimi i fondeve publike për shpëtimin e bankave; dhe (iv) mbrojtja e depozituesve, investitorëve, fondeve të klientëve dhe aktiveve të tyre. Qëllimi kryesor i veprimeve të planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme mbetet “ti bëjë bankat të gatshme për të ndërhyrë”. Planifikimi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme është një proces i vazhdueshëm dhe planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme duhet të hartohen dhe përditësohen çdo vit. Ky proces qarkullues i planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme tregohet në grafikun e mëposhtëm:



Burimet e informacionit për planifikimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme kërkojnë bashkëpunim të ngushtë me mbikëqyrësin si dhe me bankën. Ky bashkëpunim përfshin takime dhe seminare, si dhe ofrim informacioni, për shembull, përmes formularëve standardë të raportimit të funksioneve kritike dhe për infrastrukturën e tregut financiar (FMI) si dhe formularëve të tjerë të EBA-s. Në BE, SSM-ja dhe SMR-ja zhvillojnë takime të rregullta dhe i ofrojnë njëri tjetrit informacion dhe konsultime për planet e rimëkëmbjes dhe planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme (përfshirë MREL). Gjithashtu, kërkohet pjesëmarrja në takime të nivelit të lartë. **Planifikimi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme duhet të bëhet pjesë e përditshme e veprimtarisë së bankave**, veçanërisht duke: (i) i kushtuar kohë të mjaftueshme administrimit; (ii) reduktuar kompleksitetin; (iii) përditësuar sistemet e informacionit; (iv) pasur sisteme të brendshme të vlerësimit që gjenerojnë vlera të aktiveve të bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme; dhe (v) vlerësuar ndërlidhjen e brendshme dhe të jashtme. Bashkëpunimi i bankave është thelbësor për planifikimin e suksesshëm të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe trajtimin e pengesave ndaj mundësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme.



Shembull i shtrirjes kohore - bankë me kolegji të ndërhyrjes së jashtëzakonshme



Vlerësimi i mundësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme është pjesë e detyrueshme e një plani të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Një vlerësim i ndërhyrjes së jashtëzakonshme pasqyron mundësinë për të likuiduar apo zbatuar instrumentet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në një bankë me ndikim të kufizuar në stabilitetin financiar apo funksionet kritike dhe pa u drejtuar për fonde tek mbështetja financiare publike. Para se të iniciohet një vlerësim, është e rëndësishme të mblidhet informacion dhe të zhvillohet një panoramë për mjaftueshmërinë e informacionit që është në dispozicion. Një vlerësim i mundësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme jo vetëm që vlerëson ndikimin e pengesave të mundshme në strategjinë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, por dhe gjasat që pengesat e mundshme të vazhdojnë, duke hamendësuar se banka mund të shfaqë paafësi paguese në periudhën afatshkurtër ose në atë afatmesme. Autoritetet duhet të arrijnë në një përfundim të arsyeshëm dhe të rekomandojnë çdo veprim vijues, për shembull, heqjen e pengesës së identifikuar **dhe t'u kërkojnë bankave të përgatisin progres raporte lidhur me kushtet e përshtatshme të mundësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme**. Shembujt e mëposhtëm ofrojnë disa pengesa të mundshme ndaj ndërhyrjes së jashtëzakonshme:


- Afërsia përthithëse e humbjeve dhe e rikapitalizimit të bankës është e pamjaftueshme.
- Mekanizmat e transferimit të humbjeve nuk janë mjaftueshëm të fuqishme.
- Marrëveshjet për të siguruar financimin dhe likuiditetin gjatë gjithë ndërhyrjes së jashtëzakonshme rezultojnë të pamjaftueshme.
- Banka nuk është e aftë të monitorojë dhe të klasifikojë nevojat e saj për likuiditete, për fshirë brenda ditës, sipas subjektit ligjor dhe sipas monedhës si përpara dhe gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme.
- Njohje pamjaftueshme jashtë vendit e veprimeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, për shembull, për shkak të mungesës së klauzolave për ndërhyrjen e jashtëzakonshme në kontratat financiare.
- Banka nuk ka sisteme dhe procese të mjaftueshme për të qenë e aftë të ofrojë të dhëna dhe informacionin e kërkuar për planifikim të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, p.sh. për qëllime vlerësimi.



Përveç ndërveprimit të drejtpërdrejtë me banka individuale, SRB komunikon zyrtarisht pritshmëritë e saj minimale për të gjitha bankat nën juridiksionin e saj. Bankat duhet: i) të sigurojnë se strukturat ligjore dhe financuese të grupit lehtësojnë zbatimin e strategjisë së preferuar të ndërhyrjes së jashtëzakonshme; ii) zhvillojnë aftësinë teknologjike dhe operacionale për të siguruar informacionin e duhur për të mbështetur zbatimin e masave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme; iii) sigurojnë vazhdimësinë operacionale në ndërhyrjen e jashtëzakonshme; iv) ruajnë akses tek FMI⁸-të dhe ndërmjetësuesit FMI para dhe gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme; v) lehtësojnë komunikimin me autoritetet dhe palët kryesore para dhe gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme; vi) sigurojnë likuiditet në ndërhyrjen e jashtëzakonshme. Duke pasur parasysh këtë, SRB pret që bankat nën juridiksionin e saj të krijojnë “programe pune të ndërhyrjes së jashtëzakonshme” gjithëpërfshirëse për të siguruar se të gjitha pengesat e mundshme ndaj ndërhyrjes së jashtëzakonshme janë identifikuar dhe trajtuar si duhet.


SRB, në bashkëpunim shumë të ngushtë me autoritetet kombëtare të ndërhyrjes së jashtëzakonshme po rishikon politikën e saj të MREL me qëllim plotësimin e kuadrit MREL të SRB në fusha të reja kryesore dhe të përditësojë udhëzimin e mëparshëm për MREL për ato aspekte, ku Neni 45 i BRRD lë hapësirë për fleksibilitete. Për të siguruar një përlogaritje të kryer sipas MREL, përfaqja ka për qëllim të marrë parasysh zgjedhjen e instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe elementet specifike të bankës në llogaritjen e nivelit të synuar të MREL. Një përfaqje hibride për fondet e veta dhe për detyrimet e pranura ka për qëllim të rrisë besueshmërinë e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme, domethënë, kapaciteti i jashtëm për instrumente MREL mund të vlerësohet në nivel të subjektit më të lartë të grupit për vendosjen e një niveli të synuar të konsoliduar. Pritshmëritë për përfaqjen individuale dhe instrumentet e brendshme të MREL duhet të jenë të qarta: MREL individual mund të sigurojë aftësinë e degëve të përthithin humbjet në baza individuale. Ndërsa MREL i brendshëm mund të sigurojë se humbjet përthithen mjaftueshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga degët tek mëma (pika e zbatimit të ndërhyrjes) pa ndikuar strukturën e pronësisë së degëve. Sipas politikës së re (me qëllim përputhshmërinë me aftësinë përthithëse të humbjeve totale - TLAC⁹), mund të krijohet varësia për të përmirësuar mundësinë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe mund t'i kushtohet vëmendje parimit “asnjë kreditor nuk përkeqësohet” kur instrumentet e ri-kapitalizimit renditen në radhë përparësie të njëjta me detyrimet e përjashtuara nga ri-kapitalizimi.

MREL nga një këndvështrim i jashtëm.



⁸ FMI – (ang.): Financial Market Infrastructure.

⁹ TLAC - (ang): Total Loss Absorbing Capacity).




Qëllimi i MREL është të sigurojë ndërhyrje të jashtëzakonshme efektive tek një grup bankar. Humbjet pritet të centralizohen në pikën e zbatimit të ndërhyrjes dhe të përthithen nëpërmjet instrumenteve MREL të jashtëm. Nëse ka humbje në një degë, MREL individuale dhe të brendshme mund të garantojnë se grupi ka instrumente të mjaftueshëm MREL të emetuara së brendshmi për të siguruar një transferim të butë të kapitalit (përthithje të humbjeve nga mëma) duke ruajtur një strukturë të pandryshuar aksionare të bijës. Kjo do të jetë pjesë e një politike të ardhshme MREL.


Zj. Vasilika Kota, Drejtore e Departamentit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në Bankën e Shqipërisë ndau përvojën aktuale të ndërmarrjes së raundit të parë të planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në Shqipëri. Së pari, ajo ofroi një përmbledhje të përgjithshme të sistemit bankar shqiptar dhe karakteristikat e tij kryesore. Shqipëria është një ekonomi e vogël e hapur me një normë rritjeje nominale prej 4.3% në fund të gjysmës së 2018.

Aktivet e sistemit financiar përbejnë 107.7% të prodhimit të brendshëm bruto (PBB), ku sektori bankar zë peshën më të madhe prej 97.1% të PBB-së. Sektori bankar është i mirë-kapitalizuar, me një raport të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 18.2%, dukshëm mbi atë të kuadrit rregullator prej 12%, normat e fitimit vazhdojnë të përmirësohen si rrjedhojë e shpenzimeve më të ulëta për provigjione. Raportet hua ndaj depozitave, në nivele të ulëta, tregojnë rreziqe të ulëta të financimit dhe burime të mjaftueshme financimi për të mbështetur veprimtarinë kryesore të bankës, atë të ofrimit të kredive.

Ligji shqiptar për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme dhe Rimëkëmbjen, Ligji nr. 133/2016 "Për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme dhe Rimëkëmbjen e Bankave në Shqipëri" është një transpozim i BRRD-së. Banka e Shqipërisë është caktuar si autoriteti i ndërhyrjes së jashtëzakonshme për bankat dhe degët e bankave të huaja që veprojnë në Shqipëri dhe ushtron të drejtat e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të ndara nga detyrat e tjera të saj. Të drejtat ndërhyrjes së jashtëzakonshme nuk janë objekt i ndonjë njoftimi sipas ligjeve të tjera. Gjithashtu, Shqipëria ka ngritur fondin për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, i cili është plotësisht funksional. Niveli i synuar i fondit është 0.5% e totalit të detyrimeve, llogaritur si diferencë midis aktiveve dhe kapitalit të të gjithë bankave, për t'u arritur në vitin 2027 nëpërmjet kontributeve vjetore të bankave. Nëse nevojitet, mund të grumbullohen edhe kontribute të jashtëzakonshme, nëpërmjet huamarrjes nga qeveria, për të mbuluar ndonjë diferencë në fond.

Banka e Shqipërisë është në proces hartimi të planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme që kanë për qëllim të sigurojnë një zbatim të shpejtë dhe të mirë-strukturuar të instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Duke lehtësuar përdorimin efektiv të të drejtave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme mbështesin vazhdimin e funksioneve kritike duke e bërë ndërhyrjen e jashtëzakonshme të çdo banke të lehtë, pa ndërprerje dhe pa ekspozuar taksapaguesit ndaj humbjeve. Plani gjithashtu identifikon pengesa ndaj ndërhyrjes së jashtëzakonshme të cilat nevojitet të hiqen, dhe në mënyrë më të përgjithshme, ofron diskutim të çështjeve të vështira në kohën e duhur dhe para çdo përkeqësimi.






Banka e Shqipërisë miratoi një akt nënligjor për planifikimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në Prill 2018 dhe publikoi formularët e mbledhjes së informacionit dhe të dhënave bashkë me udhëzuesin shoqëruar (bazuar në formularët e SRB-së dhe EBA-s) në Maj 2018. Puna për procesin e planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme nisi me identifikimin e funksioneve kritike duke pasur parasysh vlerësimet e tyre në planet e rimëkëmbjes. Miratimi i një akti nënligjor për MREL dhe puna për një politikë MREL aktualisht është në vazhdim si pjesë e raundit të saj të parë të planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.


Objekti i ndërhyrjes së jashtëzakonshme shtrihet në përcaktimin e perimetrit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Ndër elementet kryesorë të analizës së veprimtarisë strategjike, Banka e Shqipërisë veçon:

- Mbajtjen e sistemeve dhe platformave të duhura mbështetëse të TI me një shpërndarje të qartë të funksioneve kritike.
- Vlerësimin e veçueshmërisë për të identifikuar tërësinë e veprimtarive të ndërlydhura ngushtë për t'u trajtuar si njësi e vetme në rast të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.
- Identifikimin e subjekteve të rëndësishme të grupit.
- Diskutimin e planifikimit të kapitalit dhe administrimit të likuiditetit me qëllim mbështetjen e vlerësimit të funksioneve kritike dhe linjave kryesore të biznesit.
- Përcaktimin e strategjisë së preferuar të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe vlerësimin e besueshmërisë dhe zbatueshmërisë së likuidimit të detyruar
- Përlllogaritjen e aftësisë së përthithjes së humbjeve dhe nivelit të synuar për MREL.

Duke u përqendruar në punën aktuale të identifikimit të funksioneve kritike, Banka e Shqipërisë përdor një përfaqje prej dy hapash për të vlerësuar funksionet ekonomike kritike të kryera nga bankat. Hapi i parë analizon ndikimin e ndërprerjes së papritur të funksionit ("vlerësim i ndikimit"), ndjekur nga vlerësimi i tregut për funksionin ("analiza e ofertës"), duke vlerësuar nëse një funksion dhe roli i tij mund të zëvendësohet lehtësisht nga pjesëmarrësit e tjerë të tregut - duke përfshirë pjesëmarrës të




rinj- të madhësisë dhe cilësisë së krahasueshme me kosto të pranueshme dhe brenda një periudhe të arsyeshme kohe. Për të kryer këtë analizë, Banka e Shqipërisë analizon rezultatet e një rishikimi nga poshtë lart për vetë-vlerësimin e bankave të nivelit të kritikalitetit, ashtu si përfshihet në planin e rimëkëmbjes, dhe një rishikim kritik nga lart poshtë të kryer nga autoriteti bazuar në përjasjen prej dy hapash. Në rishikimin kritik të saj nga lart poshtë, Banka e Shqipërisë përdor të dhënat e dërguara nga bankat në kuadrin e planit të rimëkëmbjes dhe zhvillon një bazë të dhënash të detajuara për të hartuar një analizë prej dy hapash nga perspektiva nga lart poshtë për të siguruar një vlerësim sasior dhe cilësor për çdo nën funksion individual dhe funksion ekonomik (si paraqitet më poshtë në grafik). Kjo përjasje ka për qëllim të mbështesë hartimin e strategjisë së duhur të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke siguruar ruajtjen e funksioneve kritike, duke mbështetur vlerësimin e planeve të rimëkëmbjes për vetidentifikimin e funksioneve kritike nga bankat.



Në përgjithësi, rezultatet kryesore nga planet e rimëkëmbjes të vlerësuar këtë vit, tregojnë raste të mos identifikimit të asnjë funksioni kritik nga bankat e mëdha përkundrejt funksioneve kritike të identifikuar nga bankat e vogla. Ka të dhëna dhe analiza të pamjaftueshme mbështetëse lidhur me vlerësimin e kritikalitetit dhe nuk është kryer një shpërndarje e funksioneve kritike me linjat kyçe të veprimtarisë dhe njësitë e dhura përgjegjëse. Banka e Shqipërisë thekson nevojën për koordinim dhe koherencë më të fortë në raportime për qëllime të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe rimëkëmbjes.

Banka e Shqipërisë është në proces të hartimit të një akti nënligjor për përcaktimin e MREL bazuar në propozimin e fundit të BRRD2. Çështjet kryesore që duhet të analizohen përfshijnë radhën e mbulimit së humbjeve, trajtimin e shkeljeve (shuma maksimale që mund të shpërndahet - MDA) dhe përbërjen e instrumenteve të detyrueshëm (kapitali përkundrejt borxhit). Përsa i përket MREL, shuma duhet të jetë e mjaftueshme, së pari për të përthithur humbjet dhe së dyti për të kthyer normat e kapitalit për të ruajtur licencën dhe mbështetur besimin e tregut. Përyjashtimet duhet të jenë përcaktuar qartë në planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Fushat që ende kanë nevojë të zhvillohen në më shumë detaje përfshijnë çështjen e kërkimit të varësisë detyruese përkundrejt asaj vullnetare dhe çështja e MREL të brendshme ndaj asaj nga jashtë në varësi të strategjisë SPE/MPE të grupeve. **Sfidat kryesore për Shqipërinë** mbeten dhe përqendrohen në: i) ndërtimin e MREL për bankat që veprojnë sipas




një modeli financimi të bazuar në depozita në një treg kapitali të nën zhvilluar; ii) trajtimi i bankave vendase përkundrejt degëve të bankave të huaja nën dritën e MREL të brendshme; iii) kufizimet në thellësinë e tregut - efektet e përhapjes; dhe iv) në periudhën e fazë së fillimit të zhvillimit gradual (phase-in) përkundrejt rrezikut ndaj mundësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme.

Përvoja e Kroacisë në operacionalizimin e rimëkëmbjes dhe të planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, prezantuar nga z. **Roman Šubic**, Zëvendës Guvernator i Bankës Kombëtare të Kroacisë. Nga një këndvështrim i ndërhyrjes së jashtëzakonshme, Banka Kombëtare e Kroacisë, merr parasysh institucione të tjerë me rëndësi sistemike (O-SIs) si dhe disa banka më të vogla që plotësojnë kriteret për ndërhyrje të jashtëzakonshme. Shtatë grupe bankare konsiderohen si O-SII (përfshirë 3 shoqëri kursim-krediti), prej të cilave një grup është shtetëror, të tjerët janë degë të grupeve të BE-së. Aktivitet individuale të këtyre bankave janë më shumë se 2.5 miliard euro dhe totali i aktiveve të këtyre bankave përbën 92% të totalit të aktiveve bankare (rreth 48.1 miliard euro). Instrumenti i preferuar i ndërhyrjes së jashtëzakonshme për këto banka, në parim, është rikapitalizimi i hapur i bankës nëpërmjet MREL. Bankat e vogla gjithashtu konsiderohen të përshtatshme për ndërhyrje të jashtëzakonshme. Janë 14 subjekte në këtë kategori (13 banka dhe një shoqëri kursim-krediti) me aktive individuale më pak se 1.5 miliard euro. Totali i aktiveve të këtij grupi bankash përbën 4.4 miliard euro, rreth 8% të totalit të aktiveve bankare. Edhe në qoftë se nuk ofrohen funksione kritike nga një bankë e tillë, interesi publik mund të identifikohet në momentin e (situatës së paaftësisë paguese) FOLTF nëpërmjet arritjes së objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Instrumenti i preferuar i ndërhyrjes së jashtëzakonshme për këto banka të vogla, në parim, pritet të jetë shitja e aktiveve dhe ndarja e aktiveve. Në praktikë, për bankat shumë të vogla, likuidimi i detyruar është strategjia e preferuar. Këshilli Evropian miratoi një skemë të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për bankat nën 1.5 miliard euro nën regjimin e ndihmës nga shteti dhe të kushtëzuar me qëllimin detyruar të ri-kapitalizimit (të të gjithë kapitalit dhe detyrimeve, përjashtuar depozitat të detyrueshme për mbulimin nga skema e garancisë së depozitave (SGD)). Skema u miratua për vetëm 6 muaj dhe mund të zgjatet.

Në Kroaci, Banka Kombëtare Kroate dhe Agjencia Shtetërore për Sigurimin e Depozitave dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Banka janë përgjegjëse për ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka. Roli i Bankës Kombëtare konsiston kryesisht në planifikimin e veprimeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme para fillimit të procesit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe është përgjegjëse për ndërhyrjet e hershme, identifikimin e bankave që kanë paftësi paguese apo që ka gjasa të kenë, dhe për të përcaktuar nëse kërkesat për mbrojtjen e interesit publik me veprime të ndërhyrjes së jashtëzakonshme janë përmbushur. Agjencia Shtetërore për Sigurimin e Depozitave dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Banka është autoriteti i ndërhyrjes së jashtëzakonshme për të gjithë institucionet që janë në proces zbatimi të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe për administrimin e fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, ndërsa administrojnë gjithashtu sistemin e sigurimit të depozitave dhe fondin e sigurimit të depozitave. Është krijuar në vitin 1994, dhe që prej atëherë ka kryer më shumë se 600 milion euro pagesa për depozituesit e siguar në 28 banka dhe institucione kursimi (më shumë se 208.000 klientë). Niveli i synuar i fondit të sigurimit prej 2.5% i totalit të depozitave të siguruara është arritur (totali i depozitave të siguruara > 24 miliard euro, dhe niveli i synuar i fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme prej 1% i depozitave të siguruara duhet të arrihet në 2024).





Departamenti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme i Bankës Kombëtare të Kroacisë u vu në funksionim të plotë në 1 janar 2015, dhe është i organizuar si departament i pavarur nën varësinë e Zëvendësguvernatorit. Nisi punë me katër punonjës dhe erdhi duke u rritur në rreth 10 punonjës me kohë të plotë, prej tyre 5 ekonomistë, 2 ekspertë ligjorë, 1 stazhier, një sekretare dhe drejtori. Si është e detyrueshme nga BRRD, ka një ndarje strikte midis fushës mbikëqyrëse përgjegjëse për planifikimin e rimëkëmbjes dhe njësisë për ndërhyrjen e jashtëzakonshme brenda Bankës Kombëtare Kroate ("Muri kinez") që i shtohet këtij kompleksiteti. Nëpunësit e njësisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme mund të aksesojnë të gjitha të dhënat e disponueshme të mbikëqyrjes, por në praktikë, të dhënat për planifikimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme më së shumti janë mbledhur në baza ad hoc nga bankat, pasi planifikimi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme kërkon të dhëna sasiore dhe cilësore që nuk janë të disponueshme nëpërmjet raporteve mbikëqyrëse. Të dhënat nga planet e rimëkëmbjes mund të jenë të dobishme, por plotësia dhe saktësia e tyre ende përbën problem. Gjithashtu, autoritetet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme duhet të vlerësojnë të gjitha të dhënat e marra nga bankat pasi ato janë përgjegjëse për cilësinë e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Shkëmbimi i informacionit midis njësisë mbikëqyrëse dhe njësisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme në Bankën Kombëtare të Kroacisë është përcaktuar nëpërmjet procedurave të brendshme në përputhje me dispozitat përkatëse në fuqi të ligjit kombëtar dhe Udhëzimeve të ndryshme të EBA-s që mbulojnë çështje specifike të shkëmbimit të informacionit midis autoriteteve mbikëqyrëse dhe të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Bashkëpunimi brenda institucionit dhe ndër institucional dhe shkëmbimi i informacionit midis Bankës Kombëtare të Kroacisë dhe Ministrisë së Financave dhe Agjencisë Shtetërore për Sigurimin e Depozitave dhe Ndërhyrjes së Jashtëzakonshmen në Banka për të gjitha çështjet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme përcaktohen në Ligjin Kombëtar për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshmen. Për më tepër, ka marrëveshje të veçanta të nënshkuara me Agjencinë Mbikëqyrëse të Shërbimeve Financiare dhe Agjencinë Shtetërore për Sigurimin e Depozitave dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Banka për bashkëpunim dhe shkëmbim të informacionit në nivel teknik. Niveli i larët i bashkëpunimit është arritur nëpërmjet Këshillit të Stabilitetit Financiar (gjithashtu i përcaktuar nga një ligj kombëtar i veçantë).



Sipas BRRD-së, autoritetet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme mund të vlerësojnë planet e rimëkëmbjes nga një këndvështrim shumë i ngushtë në drejtim të pengesave të mundshme ndaj ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Autoriteteve mbikëqyrëse nuk ju kërkohet të krahasojnë planet e rimëkëmbjes me ato të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Si rrjedhim, për momentin nuk ka një perspektive reale të integruar midis planifikimit të rimëkëmbjes dhe atij të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. **Problemi i ndërveprimit midis planeve të rimëkëmbjes dhe atyre të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe roli i autoriteteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në vlerësimin e planeve të rimëkëmbjes është një nga përparësitë e komitetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të BE-së për vitin 2019.**

Sipas BRRD-së, ndërhyrja e jashtëzakonshme më shumë se sa likuidimi i detyruar është e mundur vetëm për institucionet ku ekziston interesi publik. Në Kroaci, interesi publik më së shumti përcaktohet nëpërmjet ekzistencës së funksioneve kritike dhe ndikimit në stabilitetin financiar. Banka Kombëtare e Kroacisë ka zhvilluar një metodologji për vlerësimin e funksioneve kritike dhe vetëm institucionet O-SII (7 grupe bankare) kanë një ose më shumë funksione kritike. Vlerësimi i ndikimit në stabilitetin financiar vlerësohet me mbështetjen e Departamentit të Stabilitetit Financiar dhe kryhet rast pas rasti. Planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme për bankat e vogla janë shumë të thjeshtë sepse ato parashikojnë veprimet normale të likuidimit në rast falimentimi. Është planifikuar që për të gjithë O-SII të në Kroaci mund të zbatohet ndërhyrja e jashtëzakonshme në rast falimentimi, dhe janë hartuar planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme për të gjithë subjektet përveç njërit. Deri më sot, instrumenti i ri-kapitalizimit është opsioni i preferuar i ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe nevojiten të përcaktohen instrumente alternativë.

Ka pasur vetëm një rast të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në Kroaci prej vitit 2015, tek një bankë rajonale e rëndësishme me madhësi mesatare. Procesi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme zgjati tre vite dhe u ekzekutua operacionalisht sipas skemës së miratuar të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të Komisionit Evropian (KE) për institucionet e vogla në Kroaci. Veprimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme (3 instrumente të ndërhyrjes së jashtëzakonshme: ri-kapitalizimi; shitja e veprimtarisë dhe ndarja e aktiveve) u kryen të gjitha në përputhje të plotë me BRRD-në dhe vendimet e KE-së të cilat reduktuan të gjithë rreziqet operacionale dhe ligjore. Ndërhyrja e jashtëzakonshme tek Banka Jadranska banka d.d. u gjykua të ishte me interes publik, pasi ajo ofronte funksione kritike në një vend bregdetar kroat, ku pesha e saj në treg për kreditë dhe depozitat e klientëve ishte midis 20% dhe 40%. Për më shumë, kishte më shumë se 250 milion euro depozita të siguruara të cilat mund të ushtronin presion ndaj fondit të sigurimit të depozitave. Banka ra në skemën e ndihmës shtetërore të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për bankat e vogla. Ri-kapitalizimi ishte më i madh se 8% dhe fondi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme ndërmori gjithashtu dhe mbulimin e disa kostove të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. ASD gjithashtu kontribuoi në shumën me të cilën depozitat e mbuluara mund të ishin zhvlerësuar nëse do të ishin përfshirë në qëllimin e rikapitalizimit. Një kompani shtetërore e administrimit të aktiveve u krijua për të blerë kreditë me probleme. Blerësi nuk u lejua të përdorte licencën, emrin tregtar, apo logon e Bankës Jadranska. Procesi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme zyrtarisht përfundoi në Qershor 2018 kur O-SII shtetërore mori aksionet e bankës Jadranska. Blerja u krye nëpërmjet procesit të ankandit në treg të hapur dhe përfituesi ofroi çmimin më të mirë për aksionet e bankës.

Z. Radek Urban, Drejtor i Departamentit për ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, Banka Kombëtare e Çekisë, trajtoi përfaqshen e Bankës Kombëtare të Çekisë ndaj strategjive të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, nëpërmjet shpjegimit të planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, dhe zhvillimit të strategjive dhe instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Kuadri i ndërhyrjes



së jashtëzakonshme për bankat e falimentuara u justifikua pasi bankat ofrojnë funksione kritike. Ato mund të kenë ekskluzivitet për disa funksione (mbajta e depozitave, pagesat) dhe një pozicion të fuqishëm në treg për disa funksione të tjera (kreditim, tregjet e kapitalit). Mund të ketë interes publik në sigurimin e vazhdimësisë të funksioneve kritike ndaj agjentëve të tjerë në ekonominë kombëtare. Interesi publik testohet për të verifikuar praninë dhe rëndësinë e funksioneve kritike të cilat janë përcaktuar jo vetëm nga pesha e tregut por edhe nga aspekte të tjera, përfshirë qëndrueshmërinë, të cilat përbëjnë elementë të rëndësishëm për t'u analizuar.

Një bankë qendrore e fortë përcaktohet nga pavarësia politike, buxhetore dhe personale dhe nga mekanizmat përkatës të përgjegjshmërisë. Në trajtimin e funksioneve të ndryshme që një bankë qendrore mund të kryejë, theksohet se ndërsa banka qendrore është gjithmonë autoriteti monetar, mund të jetë njëkohësisht autoriteti mbikëqyrës (prudencial dhe drejtues), autoriteti makroprudencial dhe financiar, dhe/ose autoriteti i ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Vendimi se cilët autoritete të vendosen brenda bankës qendrore është gjithmonë politik dhe reflekton preferencë rregullatore. Në fusha të tjera të politikës të bankës qendrore (përtej politikës monetare) bashkëpunimi është thelbësor. Bashkëpunimi i autoriteteve për stabilitetin makroprudencial, mbikëqyrjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme ndikon pozitivisht stabilitetin e bankave dhe të sektorit financiar. Bashkëpunimi gjithmonë shihet pozitiv edhe nga agjencitë vlerësuese.

Republika e Çekisë është anëtare e BE-së, por nuk bën pjesë në unionin bankar. Kështu që, zbatohen CRR¹⁰/CRD dhe BRRD, por jo SRMR¹¹. Tregu Financiar i Çekisë mbizotërohet nga banka. Banka Kombëtare e Çekisë është anëtare e kolegjeve mbikëqyrëse të kryesuar nga BQE/SSM dhe e kolegjeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të kryesuar nga SRB-ja. Kjo pasqyron strukturën e pronësisë së bankave çeke, ku pesë bankat më të mëdha çeke zotërohen nga banka mëmë të euro zonës.

Ndërhyrja e jashtëzakonshme në bankë ka për qëllim të sigurojë se bankat nuk janë shumë-të-mëdha-për të falimentuar (too big to fail) dhe se taksapaguesit nuk duhet të mbartin koston e ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Ende, mund të ketë raste të krizës sistematike kur autoriteti i ndërhyrjes së jashtëzakonshme nuk mund të zgjidhë i vetëm krizën. Atëherë nevojitet bashkëpunimi midis autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe qeverisë (autoriteti fiskal). Një memorandum mirëkuptimi mund të jetë instrument i përshtatshëm për këtë rast dhe është praktikë e mirë të ndërtohet një mirëkuptim i përbashkët dhe të përmirësohen marrëdhëniet e punës nëpërmjet simulimit të ushtrimeve që përfshijnë një bankë që ka falimentuar. Për shkak të ndalimit të financimit monetar, banka qendrore nuk mund të zgjidhë gjithçka, dhe stabiliteti financiar është përgjegjësi e përbashkët. Autoritet fiskale luajnë rol thelbësor në rikapitalizimin parandalues, sigurimin e ndihmuesve të ndryshëm fiskalë, ndihmën shtetërore (jo vetëm me likuiditet) dhe zbatimin e instrumenteve stabilizues të qeverisë. ASD përfshihet në rastin e një bankë me paaftësi paguese në dy raste. Gjatë likuidimit, i cili zakonisht zbatohet për bankat e vogla, që nuk kanë funksione kritike të identifikuar, domethënë nuk ka interes publik që të vazhdojnë veprimtarinë e tyre, preket fondi i sigurimit të depozitave (në varësi të fondeve të mjaftueshme). Në ndërhyrjen e jashtëzakonshme tek bankat e mesme dhe të mëdha/me rëndësi sistematike me shumë funksione kritike, fondi i sigurimit të depozitave mund të kontribuojë, por madhësia e tij është e kufizuar.

¹⁰ Rregullorja për kërkesat e kapitalit (CRR), (EU) No 575/2013.

¹¹ SRMR – (ang.): Single Resolution Mechanism Regulation.




Identifikimi i strategjive dhe instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme varet nëse banka është e huaj apo vendase, dhe në diskutimet në kolegje dhe me autoritetin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në nivel grupi duke përfshirë përcaktimin e përgjithshëm të një SPE përkundrejt një strategjie MPE.

Zgjedhja e instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme varët nëse një bankë konsiderohet të ofrojë funksione kritike, si jepet në tabelën e mëposhtme.

Function	Description	Subfunctions
Deposit Taking	acceptance of deposits from non-financial counterparties	households; non-financial corporations – SMEs; non-financial corporations - non-SMEs; general governments
Lending and Loan Servicing	provision of funds to non-financial counterparties (retail, corporate, etc.)	households - house purchase; households - other lending; non-financial corporations – SMEs; non-financial corporations - non-SMEs; general governments
Capital Markets & Investment Activities	issuance and trading of securities, related services (market making, asset management); principal investments	secondary markets / trading – derivatives; asset management; GovBonds: primary market / secondary market; PRIBOR
Payments, clearing, custody and settlement	provision of payments, clearing and settlement services as an intermediary between own clients or client-FMIs	payment services to MFIs; payment services to non-MFIs; cash services; securities settlement services; CCP clearing services; custody services
Wholesale Funding Markets	lending & borrowing to and from financial counterparties (ex intra-group)	borrowing; lending; securities financing transactions (repo)

Në varësi të identifikimit të funksioneve kritike, bankat kategorizohen për qëllime të planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Institucionet e vogla dhe pa rëndësi sistemike, jo të identifikuar si ofrues të rëndësishëm të funksioneve kritike, për të cilat nuk mund të ketë interes publik në ndërmarrjen e veprimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, do të likuidohen sipas procedurave të likuidimit të detyruar, nëse këto procedura janë të besueshme dhe të realizueshme. Për të tilla banka mund të zbatohen detyrime të thjeshtuara për planifikimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Në kategorinë e dytë janë institucionet të cilët janë identifikuar si ofrues të rëndësishëm të një ose një numri shumë të kufizuar të funksioneve kritike, veçanërisht në pranimin e depozitave dhe në kryerjen e pagesave që lidhen me to. Në parim ky është rasti për bankat që kanë llogari transaksioni > 50,000 – 70,000; depozita të mbuluara > (CZK) 30 – 40 miliard korona çeke dhe totalin e aktiveve < CZK 150 – 200 miliard). Për këtë kategori, interesi publik në ndërmarrjen e ndërhyrjes së jashtëzakonshme parashikohet kryesisht për shkak të funksioneve kritike të identifikuar dhe sepse likuidimi nuk është i besueshëm. Nuk mund të zbatohen detyrimet e thjeshtuara. Institucionet komplekse dhe me rëndësi sistemike të identifikuar si ofrues të rëndësishëm të një numri të madh funksionesh kritike dhe falimentimi i mundshëm i të cilave mund të çojë në kërcënim serioz ose në ndërprerje të stabilitetit financiar trajtohen në një kategori të tretë. Për këto banka që kanë një total të aktiveve > CZK 150 – 200 miliard korona çeke, interesi publik në ndërmarrjen e veprimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme paraqitet i përsheptuar, kryesisht për shkak të numrit të madh apo natyrës komplekse të funksioneve kritike të ofruara dhe rrezikut të lartë të kërcënimit të stabilitetit financiar ose të ndërprerjes në rast falimentimi. Likuidimi nuk konsiderohet i besueshëm dhe detyrimet e thjeshtuara nuk mund të zbatohen.

Për ta përmbledhur, në varësi të kompleksitetit të bankës (dhe ofrimit të funksioneve kritike) një bankë e tillë do të: 1) likuidohet dhe depozitat e siguruar do të paguhet; 2) vendoset në ndërhyrje



të jashtëzakonshme duke zbatuar instrumentin e shitjes së veprimtarisë ose në mënyrë alternative një institucion urë mundësisht kombinuar me krijimin e një instrumenti të administrimit të aktiveve; 3) ose vendoset në ndërhyrje të jashtëzakonshme ndërsa banka mbahet hapur pas fundjavës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme duke zbatuar instrumentin e ri-kapitalizimit nga brenda për bankat më të ndërlikuara.

Përmbledhje e përputhjes së shkallës së kompleksitetit të bankave me funksionet kritike të ofruara, strategjitë dhe instrumentet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.


Category	Thresholds, criteria	Basic approach
Small and systemically insignificant institutions not identified as significant providers of critical functions.	No public interest in taking resolution action. Liquidation under normal insolvency proceedings is credible and feasible . Simplified obligations can be applied.	Liquidation under normal insolvency proceedings. Insured deposits paid out.
Significant providers of one or a very limited number of critical functions , especially in deposit taking and making related payments.	Public interest in taking resolution action is anticipated, mainly because of the critical functions identified. Liquidation is not credible . Simplified obligations cannot be applied. # transaction accounts > 50 – 70 000 Covered deposits > CZK 30 – 40 billion Total assets < CZK 150 – 200 billion	Resolution strategy using the sale of business tool. Alternatively, the transfer of (part of) the business to a bridge institution can be applied.
Complex and systemically important institutions identified as significant providers of a large number of critical functions and whose potential failure would lead to a serious threat to or disruption of financial stability.	Public interest in taking resolution action is anticipated, mainly because of large number or complex nature of critical functions provided and high risk of financial stability threatened or disrupted in the event of default. Liquidation is not credible . Simplified obligations cannot be applied. Total assets > CZK 150 – 200 billion	Resolution strategy using the bail-in tool.

Me qëllim, shmangien e përdorimit të parave të taksapaguesve, bankat duhet të jenë të gatshme për ndërhyrje të jashtëzakonshme: Një aspekt i rëndësishëm i shkallës së gatishmërisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme është nevoja për bankat që të ndërtojnë një MREL. Në varësi të instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, MREL konsiston në absorbim të humbjeve + rikapitalizim + shumat e besimit të tregut. MREL mund të shihet si "teoria e gjithçkaje", ose një "përjasje e përzier" e politikave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, mbikëqyrjes, dhe stabilitetit (objekt i fleksibilitetit).




$$MREL = 2 * (P1 + P2 + CBR/MCB)$$

Nuk mund të planifikohen instrumente të tjerë të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për shkak të rrezikut moral dhe aktivizimit të tyre vetëm në rast të një krize sistemike. Këto janë pronësia publike e përkohshme e subjektit dhe instrumentet e stabilizimit të qeverisë (nuk duhet të ngatërrohen me ndihmën e likuiditetit).



Zj. Sabrina Bellacci, Përgjegjëse e Sektorit 1 për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, Banka e Italisë, prezantoi krizat e fundit bankare në Itali duke u fokusuar në dy banka në Veneto. BRRD-ja ka hartuar një kuadër të ndërlikuar dhe gjithëpërfshirës ku ndërhyrja e jashtëzakonshme dhe instrumentet e saj rrinë së bashku me kuadrot kombëtarë të paaftësisë paguese, me qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar në BE dhe shtetet anëtare të saj. Rregullat për ndihmë nga shteti sigurojnë që në rast mbështetjeje publike të respektohet konkurrenca. Gjetja e një ekuilibri midis gjithë këtyre çështjeve të ndryshme është sfiduese. Kuadri është i ri, dhe përvoja e fituar deri më sot është e kufizuar në vetëm pak banka në BE, secila me tiparet e veta specifike. Nga këndvështrimi italian, ka pasur kriza të ndryshme bankare vitet e fundit, për shkak të keqadministrimit si dhe për shkak të kushteve tejet të vështira të ekonomisë reale.

Në Itali kompetencat e ndërhyrjes së jashtëzakonshme i janë atribuar Bankës së Italisë. Njësia e saj për ndërhyrjen e jashtëzakonshme dhe administrimin e krizave përgjigjet drejtpërsëdrejti para këshillit drejtues. Ajo ndahet në tre sektorë: ndërhyrja e jashtëzakonshme e institucioneve të mëdha (sipas regjimit të BQE-së/SRB); ndërhyrja e jashtëzakonshme e institucioneve më pak të mëdha (LSIs); dhe likuidimi i bankës dhe administrimi i fondeve.



Në katër banka kooperativë (Banca Marche, Banca Popolare dell'Etruria, Cassa di Risparmio di Ferrara, Cassa di Risparmio di Chieti; totali i aktiveve prej €27 miliard euro) u ndërhy në nëntor 2015 pas një periudhe të gjatë administrimi të veçantë. Ndërhyrja e jashtëzakonshme ndodhi menjëherë pas zbatimit të BRRD në Itali, por para hyrjes në fuqi të rregullit të ri-kapitalizimit nga brenda në Janar 2016. Pothuajse, e gjithë tërësia e instrumenteve të ndërhyrjes së Jashtëzakonshme u përdor (fshirja, ndarja e aktiveve, banka urë). Për shkak të mungesës së zgjidhjeve të tregut privat, dhe paaftësisë për t'u mbështetur në ndërhyrjen mbështetëse me fonde të ASD (për shkak të pengesave shtetërore të ndihmës), u aplikua ndarja e kostove të ndërhyrjes. Përputhshmëria me ndihmën e shtetit u kërkua pasi skema e ndërhyrjes së jashtëzakonshme përfshinte ndërhyrjen e fondit kombëtar të ndërhyrjes së jashtëzakonshme si për bankën urë, ashtu dhe për instrumentin e administrimit të aktiveve. Bankat urë u shitën vetëm në tremujorin e dytë të vitit 2017, me çmim prej 1 euro dhe me kontribut të rëndësishëm në kapital nga fondi kombëtar për ndërhyrjen e jashtëzakonshme.

Në rastin e dy bankave nga Rajoni i Venetos, Banca Popolare di Vicenza (BPV) dhe Veneto Banka (VB), instrumentet u aplikuan jashtë kuadrit të BRRD. Së bashku bankat kishin një total të përgjithshëm të aktiveve prej 54 miliard euro, një vendndodhje të përbashkët gjeografike, me prani të fuqishme




në rajonet veriore të Italisë; dhe ishin fokusuar në aktivitetin tradicional bankar. Në janar 2016, u transformuan nga kooperativë në shoqëri aksionare. Kriza e dy bankave ishte rezultat i një recensionit ekonomik serioz dhe të zgjatur në Itali i shoqëruar nga keqdrejtim prej drejtuesve dhe administratorëve, të cilat u shfaqën kryesisht në katër vitet e fundit. Në vitin 2017, pas rezultateve negative të provës së rezistencës, dy bankat aplikuan për rikapitalizim të parashikuar; ndërkohë situata u përkeqësua. BQE dhe KE nuk i njohën kushtet e aftësisë paguese për bankat, për shkak të mungesës së fondeve të mjaftueshme private për të mbuluar humbjet që ata me gjasë do të hasnin në të ardhmen. Pas deklarimit të paaftësisë paguese ose gjasave për paaftësi paguese nga BQE, SRB nuk e njohu interesin publik, për shkak të ndikimit të kufizuar në stabilitetin financiar në Evropë dhe Itali. Megjithatë, qeveria italiane pati shqetësime serioze lidhur me efektet e përhapjes të një likuidimi gradual nga këndvështrimi ekonomik dhe social, pasi Veneto ishte një nga rajonet industriale më të rëndësishëm në Itali. Instrumenti kombëtar i likuidimit të detyrueshëm administrativ, i shoqëruar me shitjen e aktiveve dhe të detyrimeve me ndihmën e drejtpërdrejtë shtetërore, u zbatua në përputhje me kuadrin e BE-së. Intesa Sanpaolo (ISP) mori aktivet dhe detyrimet e dy bankave, përjashtuar kreditë me probleme, një nivel pjesëmarrje dhe - nga ana e detyrimeve- kapitalin edhe borxhin e varur.

Pati ndikime mbikëqyrëse - në veçanti lidhur me praninë e huaj të VB - pas blerjes së kapitalit aksionar mbizotërues të degëve. Autoritetet italiane dhe të bashkimit evropian (si ato mbikëqyrëse dhe ato të ndërhyrjes së jashtëzakonshme) hynë në kontakt me autoritetet vendore (në Shqipëri, Moldavi, Rumani dhe Kroaci) si para ashtu dhe pas likuidimit. Autoritetet e huaja morën informacion të detajuar gjatë gjithë procesit; me shkëmbime zyrtare dhe jozyrtare. Dialogu u përqendrua kryesisht në procesin e blerjes, pjesëmarrjes influencuese, dhe kredive me probleme, me qëllim sigurimin e një tranzicioni të butë, në përputhje me kuadrin ligjor vendas.

Në kohën e likuidimit, kreditë me probleme të bankave mëmë ju lanë subjekteve të mbetura, ndërsa ISP mori përsipër provizorisht kreditë me probleme të degëve (në Itali dhe jashtë vendit). Të gjitha kreditë me probleme u kaluan në bilancin e një entiteti me qëllim të posaçëm (SPV¹²) pas një procesi të kujdesshëm dhe në përputhje me kuadrin ligjor vendas. SPV-ja nuk administroi drejtpërsëdrejti shërbimin e huave të blera. Një palë e tretë shërbyese u emërua.

Likuidimi u krye në mënyrë të tillë që të ruante vazhdimësinë operacionale të marrëdhënieve aktuale të biznesit dhe për të kufizuar efektet e krizës në ekonominë prodhuese. Mbështetja nga shteti ishte një kontribut prej 4.8 miliard euro ndaj ISP - për të mbuluar përthithjen e aktiveve dhe kostot e ristrukturimit - dhe rreth 12 miliard euro garanci (prej të cilave maksimumi 6.4 miliard euro për të garantuar zhbilancimin midis A dhe D të blera nga ISP). Shteti mundi të mbulonte, të paktën pjesërisht, fondet e disbursuara nëpërmjet shitjes së aktiveve të bankës së likuiduar (kreditë me probleme dhe aktive të tjera). Kosto e një likuidimi standard administrativ të detyrueshëm pa shitje dhe blerje ("likuidim atomistik"), e vetmja alternativë e vlefshme, do të kishte qenë shumë më e lartë për klientët (100,00 ndërmarrje të vogla dhe të mesme, 26 miliard euro kredi), sistemi bankar (10 miliard euro depozita të mbrojtura për t'u rimbursuar nga ASD, dhe madje dhe shteti. Nuk u përdor rikapitalizim, i cili do të kish përfshirë mbajtësit e preferuar për kompensim të obligacioneve dhe depozitat e pasiguruara dhe vetë shtetin (për shkak të 8 miliard euro garanci dhënë për të mbështetur situatën e likuiditetit). Aksionarët dhe mbajtësit e obligacioneve të fundit në radhë për kompensim (junior bondholders) morën pjesë në humbje; gjithashtu u përdor provigjionimi për të kompensuar disa prej mbajtës individë të obligacioneve të fundit në radhë për kompensim.

¹² SPV – Special Purpose Vehicle.



Ndërsa duke rënë plotësisht dakord me objektivat finalë të kuadrit të ri të ndërhyrjes së jashtëzakonshme u theksua se zbatimi i BRRD-së do të kishte kërkuar përmbushjen e disa parakushteve. Këto kushte duhet të analizohen me kujdes nën dritën e situatave të ndryshme të juridiksionit/sistemeve bankare si dhe një periudhe të përshtatshme tranzicioni. Në rastin e Italisë, është e rëndësishme të theksohet sa më poshtë vijon:

- Kushtet makroekonomike mjaft të shtrënguara që ndikojnë mjedisin ekonomik (rreth 10% e PBB-së dhe një çerek e prodhimit industrial humbi për shkak të krizës së zgjatur ekonomike);
- Tregje të ngrirë në thelb për aktivet e bankave (ndryshime të konsiderueshme rregullative, me kërkesa më të larta për kapital; norma të larta të kredive me probleme, fitim i ulët). Të pasurit e blerësve të vullnetshëm është element kyç për zbatimin e suksesshëm të çdo strategjie për ndërhyrje të jashtëzakonshme në kriza;
- Çështje të rëndësishme ligjore: a) ndryshime "de facto" në kushtet kontraktuale për borxhin e varur; b) shumë e madhe e obligacioneve të pasiguruara në duart e klientëve individë për shkak të regjimit të mëparshëm favorizues të taksave të obligacioneve të bankës;
- Vështirësi në zbatimin e përqasjes "një madhësi i përshtatet të gjithave" përfshirë në BRRD.

Sipas përvojës italiane u ngritën analiza si më poshtë vijon:

- Kuadri i ndërhyrjes së jashtëzakonshme i BRRD-së është efektiv për krizat idiosinkratike, po në rast kushtesh financiare/makroekonomike të shtrënguara? BRRD analizon rastin e krizës sistemike duke përdorur instrumentet stabilizues të qeverisë, por vetëm pas zbatimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. A është kjo mënyra më e mirë për të trajtuar dobësitë sistemike?
- Për të vënë në funksion ri-kapitalizmin duhet të bëhet efektiv zbatimi i kuadrit rregullativ të TLAC/MREL brenda një periudhe të duhur tranzicioni.
- Përderisa likuidimi është alternativë ndaj ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe ndërhyrja e jashtëzakonshme duket se është e përshtatshme vetëm për disa (jo për shumë) nevojitet një kuadër efektiv dhe mundësisht i harmonizuar i paaftësisë paguese. Nevojitet një rishikim gjithëpërfshirës i sistemit të përgjithshëm të administrimit të krizave, jo duke u kufizuar vetëm në ndërhyrjen e jashtëzakonshme dhe duke përfshirë ndjekjet kombëtare, gjithashtu për të shmangur dallimet midis niveleve të mbrojtjes në varësi të procedimeve që duhen ndjekur.
- Në veçanti, kur kushtet e tregut janë negative dhe nuk ka treg për aktivet bankare, mbështetja nga jashtë nevojitet për të siguruar transferimin efektiv dhe të butë të aktiveve dhe detyrimeve në likuidim. Një njohje më e thelluar e kuadrit evropian teqë trajton masat alternative të ASD-së mund të luajë rol të rëndësishëm në minimizimin e ndikimit të likuidimit.







WORLD BANK GROUP
Finance, Competitiveness & Innovation
Financial Sector Advisory Center (FinSAC)

KONFERENCA RAJONALE ME TEMË "PLANIFIKIMI I RIMËKËMBJES DHE NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME"

15 nëntor 2018
Tirana, Albania

Agjenda

- 09:00 – 09:20 **Fjala e hapjes**, Natasha AHMETAJ, Zëvendësguvernatore e Dytë, Banka e Shqipërisë
- 09:20 – 09:30 Foto grupi (të gjithë prezantuesit dhe moderatorët)
- 09:30 – 10:30 **Paneli 1: Planifikimi i rimëkëmbjes: Histori dhe çështje për t'u trajtuar**
Moderator: Denada Prifti, Përgjegjëse e Njesisë C3, Bordi i Përbashkët i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, Planifikimit dhe Vendimeve
- 09:30 – 10:00 **Përvoja e parë e planifikimit të rimëkëmbjes së bankës sipas ligjit të ri të ndërhyrjes së jashtëzakonshme**
Manjola Mançe, Përgjegjëse, sektori i Mbikëqyrjes së subjekteve individuale, Departamenti i Mbikëqyrjes, Banka e Shqipërisë
- 10:00 – 10:30 **Planifikimi i rimëkëmbjes dhe i ndërhyrjes së jashtëzakonshme nga këndvështrimi i bankave**
Eduardo Ávila Zaragoza, Përgjegjës për Marrëdhëniet Mbikëqyrëse Globale, Banco Bilbao Vizcaya Argentaria Bank (BBVA)
Elsa Martinez, Përgjegjëse e Zyrës së Planifikimit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, BBVA
- 10:30 – 11:00 Pushim për kafe
- 11:00 – 12:00 **Paneli 2: Planifikimi i rimëkëmbjes dhe i ndërhyrjes së jashtëzakonshme në BE: Zhvillimet dhe kuadri i bashkëpunimit**
Moderator: Juan Ortiz, Specialist i lartë për sektorin financiar, FinSAC, Banka Botërore
- 11:00 – 11:30 **Zhvillime të veçanta në planifikimin e rimëkëmbjes në BE**
Wolfgang Johann Gerken, Shef i Seksionit DGMS1 – Mbikëqyrja Mikroprudenciale, Banka Qendrore Evropiane
Kathrin Zander, Mbikëqyrës DGMS1 – Mbikëqyrja Mikroprudenciale, Banka Qendrore Evropiane
- 11:30 – 12:00 **Zhvillime të fundit në planifikimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në BE**
Denada Prifti, Përgjegjëse e Njesisë C3, Ndërhyrja e jashtëzakonshme në banka, planifikimi dhe vendimet, Bordi i Përbashkët i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme
- 12:00 – 13:30 Dreka
- 13:30 – 14:30 **Paneli 3: Planifikimi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme: Sfiqat e së ardhmes për vende të vogla pritëse**
Moderator: Deniz Deralla, Drejtor, Departamenti i Mbikëqyrjes, Banka e Shqipërisë
- 13:30 – 14:00 **Raundi i parë i planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në Shqipëri**
Vasilika Kota, Drejtor, Departamenti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë
- 14:00 – 14:30 **Përvoja e Kroacisë në operacionalizimin e planeve të rimëkëmbjes dhe ndërhyrjes së jashtëzakonshme**
Roman Šubić, Zëvendësguvernator, Banka Kombëtare e Kroacisë
- 14:30 – 15:00 Pushim kafe
- 15:00 – 16:00 **Paneli 4: Strategjitë dhe zbatimi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme: mësimet e deritanishme**
Moderator: Vasilika Kota, Drejtor, Departamenti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë
- 15:00 – 15:30 **Hartimi i strategjive të rimëkëmbjes**
Radek Urban, Drejtor Ekzekutiv, Departamenti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, Banka Kombëtare e Republikës Çeke
- 15:30 – 16:00 **Mësimet e nxjerra nga rastet e fundit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në banka në Itali**
Sabrina Bellacci, Përgjegjëse e Divisionit 1 të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, Autoriteti Italian i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, Banka e Italisë
- 16:00 – 16:30 **Përfundime**, BoA, BSH, FinSAC